

MAX TV
Selami DURMISHI
Drejtor
Skënderaj

Ankesa Nr. 2017/17 KPM vs MAX TV
Ref:1708/796/KPM/am

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2017/1 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër MAX TV ("Pala Përgjegjëse")

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është pajisur me Licencë të KPM-së me datën 26 nëntor 2016. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. KPM ka miratuar Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01, e cila ka hyrë në fuqi më 28 korrik 2016. Me këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur, shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
3. KPM me procedurën e përvitshme, në fillim të vitit u kërkon të gjithë operatorëve të shpërndarjes që të deponojnë katalogun e tyre të kanaleve, si dhe marrëveshjet e reja eventuale apo të skaduar për të drejtat e ritransmetimit, në bazë të Nenit 19 (*Raportimi dhe Inspektimi*), paragrafi 3, i Rregullores së lartpërmendur.
4. KPM nëpërmes një shkrese me datën 16 janar 2017 ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse që brenda dhjetë (10) ditësh të deponojë katalogun e kanaleve dhe marrëveshjet e reja eventuale apo të skaduar për të drejtat e ritransmetimit.
5. KPM nuk ka pranuar asnjë përgjigje nga Pala Përgjegjëse edhe pas kalimit të afatit prej 10 ditësh. Kështu që me datën 11 prill 2017 KPM i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje, me të cilin edhe një herë i ka kërkuar të deponojë katalogun e kanaleve dhe marrëveshjet e transmetimit të kanaleve në një afat prej pesë (5) ditësh.
6. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 15 maj 2017, ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe pas Njoftimit për Shkelje dhe kalimit të afatit të dhënë nuk e ka deponuar listën e kanaleve e as marrëveshjet për transmetimin e tyre.

Analiza Ligjore

7. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 19, paragrafi 3 të Rregullores KPM-2016/01.

Neni 19, paragrafi 3, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

“Me kërkesë të KPM-së i licencuari obligohet që të ofrojë të gjitha marrëveshjet mbi të drejtat e autorit si dhe të dhënat tjera që ndërlidhen me veprimtarinë e shpërndarjes, që janë të përcaktuara me licencë të KPM-së.”

Pala Përgjegjëse ka shkelur këtë nen duke mos i sjellë marrëveshjet mbi të drejtat e autorit.


8. KPM ka gjetur se edhe përkundër Njoftimit për shkelje Pala Përgjegjëse ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me nenin 19, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01, duke mos e deponuar në KPM katalogun e kanaleve dhe marrëveshjet e transmetimi të kanaleve.

Vendimi

9. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të vazhdueshme të nenit 19 paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01.
10. Komisioni, bazuar në nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, sanksionon me **Vërejtje** Palën Përgjegjëse për shkelje të nenit 19 paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01.

E drejta për Ankesë

11. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
12. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjrisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Adnan MEROVCI
Kryetar



10.08.2017
Datë